

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
 Ministry of Finance
 Arkiva - Arhiva - Archive

Misioni Org. Nr. Prot. 455-1/2024
 Org. Jedin. Org. Unit
 Nr. i faqeve Data 13.03.2024
 Nr. i faqeve Data
 No. pages: 01
 Data
 Djalë PRISTINE/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	Qemajl Aliu , Kryetar i Komunës së Shtimes
	Adnan Ademi , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	Elbert Krasniqi , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela , ud. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Avni Zogiani , Zv. Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve Enis Spahiu , ud. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	Bora Duli , ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve Data: 11.03.2024
Zyrtarët përgjegjës:	Referencë: 31/2024
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Razije Murtezaj , Zyrtare Ligjore, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë të aktit të Komunës së Shtimes
Lloji i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z.Aliu,
I nderuari Kryesues z.Ademi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendimi Npi-01/73 për aprovimin e rregullores komunale dhe Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba për Vitin 2024</i>
<i>I miratuar më datë 26.02.2024</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 04.03.2024</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 06.03.2024</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “Ministria”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërme të Komunës së Shtimes, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Shtimes, me anë të aktit administrativ ka synuar aprovimin e rregullores komunale dhe Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba për Vitin 2024.
2. Ligji Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal (këtej e tutje referuar si “Ligji”) e ushtron dhe/ose aplikon parimin e pavarësisë financiare të komunave kur të njëjtat zbatojnë kompetencat vetanake komunale, të precizuara më detajisht me nenin 4 të këtij Ligji.
3. Në esencë, me pavarësi financiare të komunave nënkuptohet e drejta e tyre që të posedojnë burime të mjaftueshme financiare, e me të cilat mund të disponojnë lirshëm përgjatë ushtrimit të kompetencave të tyre, kështu që ato në mënyrë të pavarur t’i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale, në pajtim me nenin 2 të Ligjit.
4. Në kontekst të të hyrave vetanake komunale, neni 8 i Ligjit në mënyrë taksative i precizon burimet që konsiderohen si kategori e të hyrave vetanake të komunave. Në këtë drejtim, taksat komunale, gjobat, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna, konsiderohen si kategori e të hyrave vetanake komunale, ashtu të trajtuara edhe me aktin administrativ komunal që është subjekt i shqyrtimit.

5. Mbi këto sqarime, Ministria vlerëson se Rregullorja është në konformitet me legjislacionin që bie në fushëveprimin e Ministrisë.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Shtimes dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve

-



Ministry of Local Government Administration

Ministry of Foreign Affairs
Department of Foreign Affairs
Ottawa, Ontario
Canada

02/20/24 4:55/2024
R-f 06 03 -24

Parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 04.03.2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIMES
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi-01/73 datë: 26.02.2024

Bazuar në nenin 12.2 pika (c) dhe 40.2 pika (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimit të Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas procesit të diskutimit Publik, në mbledhjen e mbajtur më 26.02.2024, Miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR APROVIMIN E RREGULLORES KOMUNALE PËR TAKSA, TARIFA DHE
GJOBA PËR VITIN 2024**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -II- të rregullt për vitin 2024, e mbajtur më: 26.02.2024, unanimisht, miratoi Rregulloren komunale për taksa, tarifa dhe gjoba për vitin 2024.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, Npi-01/63, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Komunitete Npi-01/69.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb - faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit:

Adnan Ademi



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi-01/74 datë:26.02.2024

Kuvendi i Komunës-Shtime	
Nr. 01-060/01-4731/24 datë: 16.02.2024	
09.03.2024	
-4- 43-189	

RREGULLORE

PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2024

Shtime 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-4731/24 datë:16.02.2024



Npi - 01/74 datë: 26.02.2024

Bazuar në nenin 12.2 shkronja (c) dhe 40.2 shkronja (g) të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Neneve 10 deri 22 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Rregulloren e MAPL-së Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Statutit të Komunës së Shtimes 01/Nr.06/1636 datë 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes, pas procesit të diskutimit Publik, në seancën e mbajtur më 26.02.2024, Mmiratoi këtë:

RREGULLOREN PËR TAKSA, TARIFA DHE GJOBA PËR VITIN 2024

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë rregullore caktohet lartësia e Taksave, Tarifave dhe Gjobave të parapara me këtë Rregullore, që janë aprovuar në Kuvendin e Komunës së Shtimes, që do t'i paguajnë personat Fizikë ose Juridikë në emër të shërbimeve të kryera, lëshimit të dokumenteve publike, përpilimit të shkresave dhe ofrimit të shërbimeve profesionale sipas kërkesës së palëve apo sipas detyrës zyrtare, lejeve të punës për ushtrimin e veprimtarisë afariste dhe tregtare, lejeve për punë profesionale, për pronësi të automjeteve, të përdorimit apo shfrytëzimit të pronës Komunale, ngarkesave për ndërtimin dhe rënimin e objekteve, për shfrytëzimin e burimeve natyrore, gjobat nga trafiku dhe gjobat për shkeljen e rregulloreve Komunale.

II LARTËSIA E TAKSAVE

Neni 2

Mbi bazën e Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës, Statutit të Komunës së Shtimes si dhe kësaj Rregullore Komunale për Taksa, Tarifa, dhe Gjoba, personat fizikë ose juridikë në emër të shërbimeve të kryera Komunale do të paguajnë Tarifën si vijon:

TAKSAT NGA SEKTORI - ADMINISTRATË E PËRGJITHËSHME

Neni 3

3.1 Lëshimi i Dokumenteve zyrtare:

3.1.1 Certifikata e lindjes.....	1.00 €
3.1.2 Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile.....	1.00 €
3.1.3 Certifikata e vdekjes.....	1.00 €
3.1.4 Certifikatë e martesës.....	1.00 €
3.1.5 Certifikatë e gjendjes martesore.....	2.00 €
3.1.6 Vërtetim nga Arkivi.....	1.00 €

3.1.7 Procesverbal për pranimin e atësisë dhe amësisë.....	1.00 €
3.1.8 Certifikatë e Shtetësisë.....	1.00 €
3.1.9 Certifikatë e vendbanimit.....	1.00 €
3.1.10 Dëshmi e vdekjes.....	3.00 €
3.1.11 Vërtetime të ndryshme.....	1.00 €
3.1.12 Deklaratë e hashkësisë familjare.....	2.00 €
3.1.13 Regjistrimet e mëvonshme të lindjes, me certifikatë.....	5.00 €
3.1.14 Regjistrimet e mëvonshme të vdekjes – me certifikatë.....	1.00 €
3.1.15 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës).....	5.00 €
3.1.16 Regjistrimi i martesës (ceremonia e martesës jashtë objektit të Komunës).....	100.00 €
3.1.17 Kërkesa, Parashtrësja, Ankesa.....	1.00 €
3.1.18 Vërtetim i mjeteve për jetesë për botën e jashtme.....	5.00 €
3.1.19 Kopje e dokumentit të vjetër nga Arkiva.....	1.00 €
3.1.20 Kërkesa për ndryshime ose përmirësime në librat AME-s.....	5.00 €
3.1.21 Kërkesa për ndryshim të emrit dhe mbiemrit.....	20.00 €
3.1.22 Ndërrimi i emrit dhe mbiemrit për familjet deri në 10 vjetë, paguhet.....	5.00 €
3.1.23 Për rikthimin e mbiemrit të vajzërisë paguhet taksa prej.....	3.00 €
3.1.24 Dokumentet e lëshuara nga E-Kiosku.....	1.00 €

3.2 Lëshimi i Certifikatave zyrtare përmes web-faqes-postes elektronike-online:

3.2.1 Certifikata e lindjes.....	2€
3.2.2 Certifikata e vendbanimit.....	2€
3.2.3 Certifikata e Martesës.....	2€
3.2.4 Certifikata e Shtetësisë.....	2€
3.2.5 Ekstrakti i lindjes.....	2€

3.3 Bazuar në nenin 63 të Ligjit për Gjendjen Civile, Nr.04/L-003, Me gjobë denohet personi që bën këto shkelje:

- 3.3.1 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 20.00 euro (minimumi) denohet personi që nuk paraqet lindjen e fëmijes në afatën e paraparë me ligj.
- 3.3.2 ku thuhet: Me gjobë në vlerë prej 50.00 euro (minimumi) denohet personi që nuk e lajmëron vdekjen në afatën e caktuar sipas ligjit.

3.4 Sipas nenit 3 Nga të gjitha pagesat lirohen si vijon:

- 3.4.1 Familjet e Dëshmorëve,
- 3.4.2 Veteranët e Invalidët me familje të ngushtë,
- 3.4.3 Ish të burgosurit politik me familje të ngushtë,
- 3.4.4 Personat me aftësi të kufizuar me familje të ngushtë,
- 3.4.5 Invalidët civil (vetëm individ);
- 3.4.6 Personat nën asistencën Sociale.

3.5 Gjithashtu lirohen nga të gjitha pagesat sipas nenit 3.1 edhe rastet që janë në fazën e aplikimit për asistencë sociale e të cilën gjë mund ta dëshmojnë me dokumentin nga Qendra për Punë Sociale se janë në fazë të aplikimit.

3.6 Parashtruesit e kërkesës sipas nenit 3.3 duhet të dëshmojnë se i takojnë njërës nga kategoritë e caktuara si dhe afërsinë familjare me parashtruesin e kërkesës.

3.7 Lirohen nga pagesa e taksës administrative parashtruesit e kërkesës për interes të përgjithshëm për lëshimin e dokumentit nën pikën 3.1.17 dhe 3.1.19 të cilën e bëjnë zyrtarët nga

institucionet shtetore/për nevoja zyrtare shtetore, Institucioneve Publike, Kryetarët e Fshatrave, Bashkësisve lokale, Përfaqësuesit e Shkollave, OJQ-ve, dhe Shoqatave Humanitare.

3.8 Nga pagesa e takses Administrative lirohen pjestarët e komunitetit RAE në bazë të Memorandumit në mes të KK-Shtime dhe CRP/K (Programi për të Drejtat Civile në Kosovë). Përkatesia etnike e këtyre komuniteteve vërtetohet nga ana e Zyrës për Komunitete (Formulari).

TAKSAT NGA SEKTORI - PLANIFIKIM, URBANIZËM, KADASTER DHE GJEODEZI

Neni 4.

4.1 Duke u bazuar në Ligjin e Ndërtimit Nr.04/L-110, Udhëzim Administrativ MMPH- Nr.02/18 për Taksat Administrative, për Leje Ndërtimore, Leje Rrërimi dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastrukturës, Drejtoria për Planifikim Urban, Kadashtër dhe Gjeodezi, përcakton këto tarifa ndërtimore për Sektorin e Urbanizmit dhe Ndërtimit:

4.2 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria I- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 1.30€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.3 Taksa Administrative për lëshimin e Lejes Ndërtimore -Kategoria II- për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 2.00€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e ndërtimit)

4.4 Tarifa për nritjen e Densitetit të Infrastrukturës për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 154.50€. Kjo taksa aplikohet vetëm për njësitë e reja të banimit. (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit)
Formula:

$$\left(\frac{\text{njesia e re banuese}}{\text{(m}^2\text{)}} \right) \times \text{Tarifa rregullat ve për nritjen e densitetit të infrastruk turës për koks banori} \\ \text{(50)}$$

4.5 Taksa Administrative për Leje Rrërimi për tërë territorin e Komunës së Shtimes, duke u bazuar nga legjislacioni i Kosovës dhe unifikimit të tij si dhe formulën e përlogaritur për vitin 2021 është: 0.70€ /m². (Formulë e cila mund të ndryshoi nga viti në vit) Formula: (Tarifa për m² x m² e ndërtimit= taksa e rrënimt).

4.6 Taksa Komunale për ndërtim të infrastrukturës, përcaktohet në bazë të nenit 17.1 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, dhe duhet të përcaktohet në bazë të Marrëveshjes për Infrastrukturë në mes aplikantit dhe organit kompetent të përshkruar në ligjin e Ndërtimit. Nr.04/L-110, neni 23, neni 7.8 dhe 9 i Udhëzim Administrativ MMPH- Nr.02/18 Për Taksat

Administrative për Leje Ndërtimore, për Leje Rrëtimi si dhe Tarifat për Rregullimin e Infrastruktura. Kontrata dohet të jetë ligjërishit e zbatueshme që specifikon termat dhe kushte për sa i përket financimit dhe sigurimit të infrastrukurës.

4.7 Nga nenet e taksave 4.2 dhe 4.3 lirohen ndërtimet e karakterit Bujqësor, Subjektet Afariste në Zonat Ekonomike në Shtime, si dhe të gjitha subjektet afariste që kanë në shfrytëzim pronat e pa luajtshme komunale në bazë të vendimeve për dhënie në shfrytëzim pronën e pa luajtshme komunale.

4.8 Referenca për projektet e realizuara në Komunën e Shtimes.....10.00 €

4.9. Ndërtimi i objekteve të infrastrukurës:

4.9.1 Për aktin me të cilën lejohe grupimi për ndërtimin e infrastrukurës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:
 4.9.2 Rrjet ujësjellësi (Për metër Gjatësi).....0.30 €
 4.9.3 Rrjet kanalizimi (Për metër Gjatësi).....0.30 €
 4.9.4 Rrjet elektrike të tensionit të ulët (Për metër Gjatësi).....0.30 €

4.10 Për aktin me të cilën lejohe grupimi për ndërtimin e trasave kabllorike dhe ajrore të infrastrukurës në hapësirat publike për persona fizik e juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.10.1 Rrjet telekomunikacioni dhe televizive (Për metër Gjatësi).....0.40 €
 4.10.2 Rrjete elektrike të tensionit të lartë (Për metër Gjatësi).....0.50 €

4.11 Për aktin me të cilën lejohe ndërtimi i objekteve të infrastrukurës në hapësirat publike për persona fizik dhe juridik, (jo institucionale dhe donator) si:

4.11.1 Antena (GSM) – (Për Copë).....150.00 €
 4.11.2 Antena – internet e të ngjajshme – (Për Copë).....100.00 €
 4.11.3 Trafostacionet Shtyllë – (Për Copë).....50.00 €
 4.11.4 Trafostacionet Blindë – (Për Copë).....100.00 €

Tarifa për shërbimet elektronike - Online

Neni 5

5.1 Për një përdorues GUI për person tarifa është.....20 €
 5.2 Për një përdorues UCWSS si institucion100 €
 5.3 Mirëmbajtja vjetore për shërbimet e ofruara online është.....200 €
 5.4 Përgjithësisht nga paragrafi 16.3 i këtij neni, bëhet për personat fizik dhe juridik të cilët regjistrojnë të drejtën e hipotekës.
 5.5 Bazuar në paragrafin 16.4 të këtij, regjistrimi i hipotekës është 5 euro, ndërsa modifikimi dhe fshirja e saj është pa pagesë.
 5.6 Verifikimi i informacioneve për njësi kadastrale është2 €
 5.7 Verifikimi i informacioneve për person është6 €
 5.8 Tarifat e përcaktuara në paragrafin 16.6 dhe 16.7 të këtij neni, vlejné për të gjitha institucionet publike dhe ato private që me ligj kanë autorizime publike.
 5.9 Nxjerrja e certifikatave online është3 €
 5.10 Lirohet nga tarifa për regjistrimin e shënimit nga përdoruesit sipas paragrafit 1 të këtij neni. Përdoruesit nga paragrafi 1 i këtij neni janë të obliguar që të bëjë rregjistrimin e shënimit.

Neni 6

6.1 Për Leje Mjedisore Komunale zbatohen procedurat në bazë të Ligjit Nr.03/L-025 Për Mbrojtjen e Mjedisit, si dhe neni 15 pika 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 datë 02.05.2017 për Dhënie e Lejes Mjedisore Komunale:

- 6.1.1 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj tarifen prej 0.2% të vlerës investuese mbi 25,000€.
- 6.1.2 Për tu paisur me Leje Mjedisore Komunale, aplikuesi duhet të paguaj 50€ për vlerë investive deri 25,000€.

TAKSAT NGA SEKTORI - SHËRBIME PUBLIKE

Neni 7

7.1 Paisja me leje Komunale për aktivitete biznesi:

- 7.1.1 Lëshimi i Lejes për punë me auto-taxi.....30.00 €
- 7.1.2 Vazhdimi i lejeve për auto-taxi.....10.00 €
- 7.1.3 Ndërrja e vijave të reje të autobusit urban dhe periferik.....50.00 €
- 7.1.4 Vazhdimi i linjave të autobusit në trafikun urban dhe periferik.....30.00 €
- 7.1.5 Regjistrimi për punë me Kioska.....15.00 €

7.2 Pëlqimi Higjieniko-teknik e Sanitar për subjektet afariste, mbi bazën e Ligjit për Inspektoriatin Sanitar, Nr.2003/22:

- 7.2.1 Objektet industriale.....10.00 €
- 7.2.2 Shitja e derivateve të naftës (pompat e benzines), depot e gazrave.....25.00 €
- 7.2.3 Restorantet, hotelet, motelet, therretoret, objektet për prodhimin e ushqimit.....25.00 €
- 7.2.4 Ordinanat shëndetsore private, barnatoret mjeksore, barnatoret bujqesore dhe laboratoret biokimike.....25.00 €
- 7.2.5 Vershërbimet SH.P.K.....15.00 €
- 7.2.6 Kuzhinat (gjelloret).....15.00 €
- 7.2.7 Embëlloret, Kafiterit.....15.00 €
- 7.2.8 Dyqanet tregëtare të pavarura.....10.00 €
- 7.2.9 Dyqanet e pavarura zejtare-tregëtare.....10.00 €
- 7.2.10 Dyqanet e pavarura zejtare-shërbyese.....10.00 €
- 7.2.11 Zyret dhe agjensitë.....10.00 €
- 7.2.12 Kiosqet.....5.00 €
- 7.2.13 Gurthyesit, Betonierkat, ekspluatuesit e zhavorit.....1.000 deri 20.000 €
- 7.2.14 Veprimtari Shërbyese në sektorin e Teknologjis Informative dhe produkteve të tyre dhe të gjitha veprimtari të kësaj lamiye.....25.00 €
- 7.2.15 Mos paisja me pëlqime sanitare, mjedisore dhe aktet tjera zyrtare do të zbatohen dispozitat ndëshkuese me ligjet, udhëzimet dhe rregulloret në fuqi.
- 7.2.16 Për zbatimin e kësaj rregulloreje janë kompetent Inspektorati Komunal dhe Policia e Kosovës.

7.3 Leje Komunale për qarkullimin e automjeteve të rënda në rrugët ku është i ndaluar qarkullimi i automjeteve në fjalë, për nevoja të ngarkimit e shlyrkimit të mallit mbi 7 ton:

- 7.3.1 Leje Komunale për rrugët: "Tahir Sinani", "Komandant Kumanova" dhe rruga "Adem Jashari" për 1 deri në 3 ditë paguhet.....10.00 €
- 7.3.2 Leje Komunale për të gjitha rrugët tjera për 1 deri në 3 ditë paguhet.....5.00 €
- 7.3.3 Leje Komunale për 1 deri në 15 ditë paguhet.....15.00 €

7.3.4 Leje Komunale, mujore për 1 Kamion.....25.00 €
 7.3.5 Leje Komunale, vjetore për 1 Kamion.....150.00 €
 7.3.6 Leje Komunale, vjetore për çdo Kamion të dytë ose më shumë i shtohen nga.....50.00 €
 7.3.7 Të gjithë operatorët që nuk janë të Komunës së Shtimes e të cilët furnizohen apo furnizojnë bizneset në komunën e Shtimes duhet të deshmojnë me fatur furnizimin apo shitjen e mallrave nëpër këto biznese që kanë leje qarkullimi mbi 7 tonë, e cila lëshohet për të gjitha veprimtaritë e bizneseve në Komunën e Shtimes vetëm nëpër rrugët të cilat janë të lejuara me rregullore komunale.

Neni 8

8.1 Taksa për pronësinë në automjet:

8.1.1 Të gjithë pronarët – poseduesit e automjeteve motorike në Komunën e Shtimes të cilat rrethohen duhet të paguajnë taksën Komunale sipas kësaj table:

Nr.	Emërtimi – Lloji i Automjeteve	Shuma €
1.	-Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme deri në 3500 kg. -Të gjitha llojet e Motoçikletave që rrethohen.	10.00
2.	- Të gjitha Automjetet me peshë të përgjithshme mbi 3500 kg. - Të gjithë Autobusët dhe Minibusët.	20.00

8.2 Lirohen nga Taksa Komunale për pronësinë në automjet si vijon:

- 8.2.1 Rimorkiot, Traktorët dhe të gjitha mjetet tjera bujqësore,
- 8.2.2 Automjetet e Emergjencës,
- 8.2.3 Automjetet e Zjarrfikësve,
- 8.2.4 Automjetet e Policisë,
- 8.2.5 Automjetet Ushtarake,
- 8.2.6 Automjetet e Komunës,
- 8.2.7 Automjetet e Organizmave Ndërkombëtar,
- 8.2.8 Automjetet e Shoqatave Jo Qeveritare
- 8.2.9 Anëtarët e familjes së ngushtë të Dëshmorit,
- 8.2.10 Veterani dhe Invalidi i UÇK-së,
- 8.2.11 Personi me Invaliditet ushtarak dhe të punës,
- 8.2.12 Personi me aftësi të kufizuar,
- 8.2.13 Ish i burgosuri politik,
- 8.3.14 Dëshmi për lirim sipas pikës 8.2.1 deri te pikë 8.2.8 është Librezë e Automjetit.
- 8.3.15 Dëshmi për lirim sipas pikës 8.2.9 dhe 8.2.10 është Kartela nga organi kompetent.
- 8.3.16 Dëshmi për lirim sipas pikës 8.2.11 Vendimi mbi Invaliditetin nga Ministria e Punës,
- 8.3.17 Dëshmi për lirim sipas pikës 8.2.12 është Vendimi nga komisioni i shëndetësisë.
- 8.3.18 Dëshmi për lirim sipas pikës 8.2.13 është Vendimi nga Shoqata e të Burgosurve politik të Kosovës.

8.3 Kiosqet (Qoshqet), Objektet Montazh, për shfrytëzim të përkohshëm të pronës Publike - Komunale, janë të obliguar të paguajnë taksën Komunale për muaj sipas kësaj Table:

Nr.	Zonat	Sasin	Çmimi për 1 Muaj
1	Zona e parë	1 m ²	2 €
2	Zona e dytë	1 m ²	1 €
3	Zona e tretë	1 m ²	0.5 €
4	Zonat rurale	1 m ²	0.5 €

8.4 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave të tregut sipas llojeve paguhën sipas kësaj tablele:

Nr	Tregu	Përshkrimi	Orë	Njesia matëse	Çmimi për Një Ditë €	Çmimi për Një Vit (Rezervin)
1.	1 Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë - Lokacion për shitje të Mallit	E premte	1 m ²	1.00	(2 m ²) 100.00 €
2.	1 Plaçkave dhe i gjelbër	Tezgë - Lokacion për shitje të Mallit	Për ç'do ditë	1 m ²	0.50	(2 m ²) 150.00 €
3.	Hapsira Publike	Shfrytëzimi i Lokacionit (polygon) për Autohikolla	Në Treg përveç ditës e Premte	Paushall	/	Çmimi për një Muaj 30€
4.	1 Kafshëve	Shitja e Kafshëve të imëta	E premte	1 Copë	2.00	/
5.	1 Kafshëve	Shitja e Kafshëve të imëta	E premte	1 Copë	0.50	/
6.	1 Gjelbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkia, etj.	E premte	1m. gjatësi	1.00	/
7.	1 Gjelbër dhe kafshëve	Shitje me Kamionë, Qerre, Rimorkia, etj.	Për ç'do ditë	1m. gjatësi	0.50	Deri 3500 kg - 100.00€ Mbi 3500 kg - 150.00€
8.	1 Plaçkave dhe i gjelbër	Parkimi i automjeteve	Përveç e Premte e Shtunë e Dielë	1 Copë	0.50	/
9.	1 Kafshëve	Peshorja e kafshëve	Për një vit	Paushall	/	150.00€

VËREJTJE: Zhavorri ose materiali ijetër ndërtimor nuk është i lejuar të zbrazet në tokë, në lokacionin e tregut.

8.5 Taksat për shfrytëzimin e hapësirave publike paguhën sipas kësaj tablele:

MBI BAZËN E PLOTËSIMIT TË KUSHTEVE, DHË LEJES TË LËSHUAR NGA ORGANI KOMPETENT I ADMINISTRATËS KOMUNALE PAGESA KRYHET NË VALUTËN EURO PËR NJË METËR KATROR SIPËRFAQE KOMUNALE-PUBLIKE QË SHFRYTËZOHET - SIPAS KËSAJ TABELË:				
PAGESA SIPAS ZONAVE - €për m ²				
Për Muaj	Zona I	Zona II	Zona III	Zona Rurale
1	5	4	3	2
2	8	6.40	4.80	3.20
3	12	9.60	7.20	4.80
4	16	12.80	9.60	6.40
5	20	16	12	8
6	24	19.20	14.40	9.60
7	28	22.40	16.80	11.20
8	32	25.60	19.20	12.80
9	36	28.80	21.60	14.40
10	40	32	24	16
11	44	35.20	26.40	17.60
12	48	38.40	28.80	19.20

SHFRYTËZIMI I PËRKOHSHËM I HAPSIRAVE KOMUNALE-PUBLIKE:	
1.	Shitje sezonale të Lëvizshme, (Frigorifer, Furrë, Cigare etj)
2.	Vendosje të Panairëve, Tregje dhe Reklamim të automjeteve,
3.	Shfrytëzimi i sipërfaqes për Reklam, të mallrave të ndryshëm
4.	Vendosja e Reklamave, pagesa për metër katror të reklamës,
5.	Vendosja e Vendosjeve, Pëshimorëve, Qadërve për bizneset etj,
6.	Vendosje të pajisjeve për lojëra të ndryshme dhe argëtim,
7.	Vendosja të përshoshmë të pajisjeve dhe materialit për ndërtim,
8.	Vendosje të Kontejnerëve për mbeturina ricikluese për m ² .
9.	Shfrytëzimi i sipërfaqes- hapësirës publike për nevoja të ndryshme të qytetarëve.
10.	Pagesa për parkimin e automjetit, dhe me rimorkio në Parkimin Publik në Rrugën kryesore - Shitme është 0.20€ (Njëzet cent) për një orë.

8.6 Për dhënie e Objekteve të mëdha ose sipërfaqeve të tokës, Komunale-Publike me qira ose në forma tjera për shfrytëzim afatshkurtë ose afatgjatë, kërkesa e palës duhet të i nënshtrohet procedurës administrative, sipas Ligjeve pozitive të Republikës së Kosovës dhe Rregulloreve të Komunës së Shtimes, dhe për të vendos Kuvendi i Komunës ose Organet e tij.

8.7 Tarifat fikse (Pa-TVSH) për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave Mëkë (të përziera) në Komunën e Shtimes.

Amvisëritë

8.7.1 Amvisëritë paguajnë tarifen mujore në shumën prej.....5.99 €

Komerciale/Industriale

8.7.2 Kategoria -I- Përfshihen, Dyqanet e vogla dhe artizanale të cilat paguajnë shumën mujore prej.....	9.59 €
8.7.3 Kategoria -II- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të ulët të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....	13.54 €
8.7.4 Kategoria -III- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të moderuar të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....	23.60 €
8.7.5 Kategoria -IV- Përfshihen, Bizneset e mesme deri të mëdha me kosto të lartë të shërbimit të cilat paguajnë shumën mujore prej.....	31.16 €
<u>Bizneset me kontrata të Veganta</u>	
8.7.6 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m ³ , paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....	15.58 €
8.7.7 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m ³ , paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....	66.11 €
<u>Institucionet me kontrata të Veganta</u>	
8.7.8 Kategoria -V- Për Kontejnerët 1.1 m ³ , paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....	15.58 €
8.7.9 Kategoria -V- Për Kontejnerët 5.1 m ³ , paguajnë për ç'do zbrazje shumën.....	66.11 €

TAKSAT NGA SEKTORI - ZHVILLIMI EKONOMIK

Neni 9

9.1 Kompensimi për shndërrimin e tokës bujqësore në jobujqësore

9.1.1 Me këtë bëhet cakimi ndryshimit të destinimit të sipërfaqeve bujqësore sipas Udhëzimit Administrativ, Nr.41/2006, lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

9.1.2 Në Komunën e Shtimes sipas strukturës ekzistojnë tetë klasë tokë bujqësore.

9.1.3 Kompensimi për ndryshim të destinimit të Tokës bëhet sipas tabelës në vijim:

Klasa I-të deri IV-të	Kompensimi	1.00 €/m ²
Klasa V-të dhe VI-të	Kompensimi	0.75 €/m ²
Klasa VII-të dhe VIII-të	Kompensimi	0.50 €/m ²

9.1.4 Përcaktimi i këlyre kuotave financiare sipas kategoriave dhe klasave është rezident vetëm për zonën urbane të ndarë në tri zona.

9.1.5 Përfshirje nga neni 8.1.4 mund të bëhen vetëm për rastet kur ndërimi i destinimit të tokës ka të bëjë me ndërtimin e Objekteve bujqësore, fermave, fidanishteve, Serrave e objekteve me karakter zhvillimi të bujqësisë.

9.1.6 Vërtetim për marrje me veprimtari bujqësore, kompensimi për persona fizikë.....2.00 €

9.2 Shërbimet Profesionale për prirje të Pyjeve Private

9.2.1 Dru zjarri për m³ në shumën prej.....1.50 €

9.2.2 Dru zjarri mbi 7 m³ në shumën prej.....2.00 €

9.2.3 Dru teknik për m³ në shumën prej.....3.00 €

9.3 Lartësia e takses për shfrytëzimin e kullësive paguhet sipas kësaj tablele:

Nr	Lloji i Bagëtisë	NB / për kokë	Euro / për kokë
1	Gjadhër mbi një vit	1	1.20
2	Veqat	0.45	0.54
3	Delet	0.18	0.22
4	Cengjal	0.1	0.12
5	Kamjët - Gomazit	1	1.20

6	Dosat	0.5	0.60
7	Darjal	0.3	0.36
8	Rosat	0.014	0.02

9.4 Certifikata që ka të bëjë me vlerësimin e pronës dhe kapitalit:

9.4.1	Pagesa në rastin kur lëshohet nga zyra mbi provat (dokumentacionit).....	5.00 €
9.4.2	Pagesa në rastin kur duhet bërë vlerësimin përmes komisionit profesional në teren dhe kur duhet sjatur procesverbalin përkatës.....	25.00 €
9.4.3	Vërtetime të ndryshme.....	1.00 €

TAKSAT NGA SEKTORI - SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Neni 10

10.1 Tarifat Komunale për dokumentat që lëshon DSHMS-e dhe QPS-e:

10.1.1	Vërtetim për Dëshmorët.....	(lirohen)
10.1.2	Formulari për trajtim jashtë vendit.....	(lirohen)
10.1.3	Vërtetimi për skemën invalidore dhe të plagosurit e luftës.....	(lirohen)
10.1.4	Vërtetim nga participimi.....	(lirohen)
10.1.5	Vërtetim i gjendjes Sociale.....	1.00 €
10.1.6	Vërtetimet tjera.....	1.00 €
10.1.7	Vërtetim që nuk i është marrë e drejta për të vepruar apo e drejta prindore.....	2.00 €
10.1.8	Vërtetim që familja nuk merit asistencë sociale (për shtetet e jashtëme).....	2.00 €
10.1.9	Vërtetim (mendim) për martesë të parakotshme.....	3.00 €
10.1.10	Vërtetim për rregjistrim të më vonshëm të fëmijëve.....	2.00 €
10.1.11	Vërtetim që është duke u kujdesur për fëmijë.....	2.00 €
10.1.12	Vërtetim që nuk i është hequr zotësia e punës dhe veprimt.....	2.00 €
10.1.13	Pëlqim për bartjen e pasurisë.....	2.00 €
10.1.14	Pëlqim për udhëtim jashtë vendit për fëmijët e moshës jo madhore.....	2.00 €
10.1.15	Kërkesë për përfqësim në Gjykatë për fëmijët lidhur me trashëgimi.....	3.00 €
10.1.16	Konstatime të ndryshme zyrtare.....	3.00 €
10.1.17	Pranimi i Aktesisë dhe Amësisë.....	3.00 €

10.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.04/2007 të datës 24.09.2007, dhe U.A.Nr. 04/2013 të datës 15.05.2013 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave për mbledhjen dhe shfrytëzimin e mjeteve nga bashkëpagesa e shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore dhe të hyrjeve vetanake të institucioneve shëndetësore, çmimet dhe pagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor është:

10.2.1	Ekzaminimi mjekësor në punkt, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë.....	1.00 €
10.2.2	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes.....	2.00 €
10.2.3	Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes.....	5.00 €
10.2.4	Ekzaminimi në shtëpi, përpos në rastet emergjente.....	6.00 €
10.2.5	Medikamenti nga lista esenciale, ofruar në barnatoren publike.....	0.30 €
10.2.6	Ultrazëri Standard.....	2.00 €
10.2.7	Radiografia.....	2.00 €
10.2.8	EKG.....	0.50 €
10.2.9	Analizat Laboratorike vetëm hemogrami dhe urina.....	1.00 €
10.2.10	Analizat laboratorike (komplet).....	3.00 €

10.2.11 Caktimi i sheqerit në gjak me glikometer sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.....	1.00 €
10.2.12 Audiogrami.....	1.00 €
10.2.13 Shpërlarja e veshit.....	1.00 €
10.2.14 Dhënja e injeksionit intra muskular në shtëpi, përpos në rastet emergjente.....	1.00 €
10.2.15 Dhënja e injeksionit intra venoz në shtëpi, përpos në rastet emergjente.....	1.00 €
10.2.16 Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërimin të plagës (vetëm në vizitat e parë).....	3.00 €
10.2.17 Trajtimi ditor me infuzione në institucionin shëndetësor.....	1.00 €
10.2.18 Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ për Certifikatat Shëndetësore Nr.04/2013, bëhet lëshimi i Certifikatave të shëndetësorë në kujdesin Primar.....	15.00 €
10.2.18.1 Certifikata shëndetësore për edukim-shkollim (Lirohen nga pagesa në sektorin publik, bazuar në Ligjin për shëndetësi, përjashtohen moshat mbi 26 vjet dhe shtetasit e huaj).....	10.00 €
10.2.18.2 Certifikata shëndetësore për punësim.....	15.00 €
10.2.19 Dhënja e raportit mjekësor, vertetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.....	5.00 €
10.2.20 Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj. për një orë.....	25.00 €
10.2.21 Vizitë e parë stomatologjike.....	1.00 €
10.2.22 RTG i dhëmbit.....	1.50 €
10.2.23 Mbushje e përherëshme me amalgam.....	4.00 €
10.2.24 Mbushje e përherëshme me kompozitë.....	5.00 €
10.2.25 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përherëshme (amalgam apo kompozitë).....	5.00 €
10.2.26 Amputimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgam-kompozitë).....	6.00 €
10.2.27 Extirpimi vital i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgam-kompozitë).....	6.00 €
10.2.28 Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgam-kompozitë).....	6.00 €
10.2.29 Extirpimi mortal i pulpës me mbushje të përherëshme (amalgam-kompozitë).....	6.00 €
10.2.30 Terapia e kanalit të infektuar të përherëshme (amalgam apo kompozitë).....	6.00 €
10.2.31 Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të përherëshme.....	6.00 €
10.2.32 Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës.....	1.00 €
10.2.33 Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave.....	1.00 €
10.2.34 Vulosja e fisurave.....	1.00 €
10.2.35 Mënjanimi i depozitimeve të buta.....	1.00 €
10.2.36 Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëzëve të dhëmbëve me ultratingull).....	3.00 €
10.2.37 Kiratizha e xhçpave parodontal (një dhëmb).....	1.00 €
10.2.38 Nxjerrja e dhëmbit.....	1.50 €
10.2.39 Incizioni intra dhe extra oral.....	1.50 €
10.2.40 Heqja e kurorës me anë të prerjes.....	1.00 €
10.2.41 Riparimi i protezës (ngjitja).....	1.50 €

TAKSAT NGA SEKTORI - ARSIMIT

Neni 11

11.1 Duke u bazuar në U.A. të MASHT-it Nr.01/2017 të datës 21.02.2017 për Planifikimin dhe Shpenzimin e të hyrave vetmaka të realizuara nga Institucionet e Arsimit dhe

Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur, pagesa për vijimin dhe përfundimin e arsimit dhe aftësimi për të rritur është:

11.1.1 Për regjistrimin e vitit.....	100.00 €
11.1.2 Për praktikë profesionale.....	50.00 €
11.1.3 Provimi diferencial.....	10.00 €
11.1.4 Provimi përfundimtar certifikatën/diplomë.....	50.00 €

11.2 Duke u bazuar në U.A. Nr.03/2013 të datës 21.01.2013 të MASHT-it, dokumentacioni publikatë lëshohet nga institucionet e arsimit përkatës në këto raste:

11.2.1 Nëse është i humbur.....	1.00 €
11.2.2 Nëse është djegë.....	1.00 €
11.2.3 Nëse është dëmtuar.....	1.00 €
11.2.4 Nëse është asgjësuar.....	1.00 €
11.2.5 Nëse është i plotësuar me gabime.....	1.00 €

11.3 Duke u bazuar në vendimin Np1-01/238, datë 15.09.2011 të Kuvendit Komunal të Shtetës për caktimin e tarifës participuese të famijve në qendër tcmi:

11.3.1 Pagesa për qëndrim ditor të një fcmi në I.P. për një muaj të plotë.....	35 €
11.3.2 Pagesa për qëndrim ditor të një fcmi në I.P. për gjysëm muaj.....	17.50 €
11.3.2 Shfrytëzimi i hapësirave të mbrendshme të Shkollave për rekreacion.....	10 €/ora

TAKSAT NGA SEKTORI KULTURË, RINI DHE SPORT

Neni 12

12.1 Lartësia e ngarkesave që du të paguajnë personat fizikë ose juridikë në anar të shërbimeve apo të veprimtarive Kulturora Komonale du të jen si vijon:

Për Bibliotekë pagesat vjetore të antarsimit janë:

12.1.1 Sektori për të rritur mbi moshën 18 vjeq.....	2.00 €/vit
12.1.2 Sektori për famijë nën moshën 18 vjeq.....	1.00 €/vit

Për Aktivitetet në Shëpin e Kulturës pagesat janë:

12.1.3 Biletë për përcjelljen e shfaqjeve teatrore.....	1.00 €
12.1.4 Biletë për përcjelljen e shfaqjeve për famije.....	1.00 €
12.1.5 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete jo kulturora.....	30.00 €/orë

Lirohen nga pagesa për pjesëmarrje në aktivitetet kulturora këto kategori:

- 12.1.6 Familjet e Dëshmorëve,
- 12.1.7 Veteranët e Invalidët me famijë të ngushtë,
- 12.1.8 Ish të burgosurit politik me famijë të ngushtë,
- 12.1.9 Personat me aftësi të kufizuar me famijë të ngushtë,
- 12.1.10 Invalidët dhe Pensionistët (vetëm individë),
- 12.1.11 Personat nën asistencën Sociale,
- 12.1.12 Vullnetarët që posedojnë dëshmi sipas kategoris së përcaktuar.

12.2 Pagesat për shfrytëzimin e objekteve dhe fushave sportive:

12.2.1 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë.....	10.00 €/orë
12.2.2 Shfrytëzimi i Sallës për aktivitete josportive për 1 orë.....	20.00 €/orë

12.3 Për aktivitetet në Stadionin e qytetit pagesat bëhen:

12.3.1 Shfrytëzimi i Stadionit për aktivitete sportive, rekreative për 1 orë.....	10.00 €/orë
---	-------------

12.3.2 Shfrytëzimi i Stadionit për aktivitete jashtëpore për 1 orë 20.00 €/orë
12.3.3 Lirohen nga pagesa për shfrytëzimin e objekteve sportive këto kategori: të gjitha klube sportive lokale të licencuara nga DKRS, të gjitha institucionet komunale të arsimit.

III. DISPOZITAT NDËSHKËSE

Neni 13

"Mospagesa për shfrytëzimin e pronës Komunale parasheli masën ndëshkuese, ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë për personat fizik, ndërsa për personat juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi për kundërvajtjet, respektivisht neni 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit Nr.05/L-087 për Kundërvajtjet".

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregullorja Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjeba për vitin 2023, me numër Npi-01/104 datë: 30.03.2023.

Neni 15

Kjo Rregullore hynë në fuqi 15 ditë nga dita e rëzhistritimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shitimes.

Neni 16

Implementimin e kësaj rregullore janë të obliguar të bëjnë: Kryetari, të gjitha Drejtoritë Komunale si dhe të gjitha institucionet në nivelin e lokal të komunës së Shitimes.

Neni 17

Rregullorja dhe Vendimi u dërgohen: Arkivit, Drejtorëve, Institucioneve lokale, Kryetarit të Komunës, MAPL, MEF dhe Zyrës për Informim.



KRYESUESI I KUVENDIT

Adnan Ademi